

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	I dërguari amerikan: SHBA-ja po “shkon në drejtimin e duhur” me Bjellorusin
ADRESA	https://www.gazetatema.net/bota/i-derguari-amerikan-shba-ja-po-shkon-ne-drejtimin-e-duhur-me-bjellorusin-i586881
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 12:30:53 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 12:30:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	e0c675893d1fcd08777dac64ef39258bc13bbace0efb94549e48cd7f204311a1
TEKSTI	fa7469d857c237d1246d2b9a06ea754cc03542f21cbddeb15f1f8a15f3932c34
PAMJA	fd198a4c20a08a2fb270d524b4ea0405f5e8a186f33f8dc1404d081485986c5e

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	06e2fb2a9c7b040adf1273a366f38af1927c77e51821acdbfe1a8838ecb374bf
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	c2d3424a52af1d7a5bda261c525771941165d93d82c499297c4e9de151b879e4
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/06e2fb2a9c7b040adf1273a366f38af1927c77e51821acdbfe1a8838ecb374bf>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)



English



I e fundit I dërguari amerikan SHBA-ja po "shkon në drejtimin e duhur" me Bjellorusin Mediat serbe kryqëzojnë artisten Leonora Jakupi. Ajo po perkrah gjarprin, Hashim Thaçin!

I dërguari amerikan: SHBA-ja po "shkon në drejtimin e duhur" me Bjellorusin



18 Shtator 2026, 14:30Bota TEMA



I dërguari i posaçëm i Shteteve të Bashkuara, John Coale, e ka mbikëqyrur lirin e qindra të burgosurve nga Bjellorusia gjatë 22 muajve të fundit, përfshirë 25 këtë javë.

Por organizatat për të drejtat e njeriut thonë se qindra të tjerë kanë mbetur në burg. Ato gjithashtu e kanë vënë në pikëpyetje qasjen e Uashingtonit për shkëmbimin e civilëve, për të cilët ato besojnë se janë burgosur padrejtësisht, në këmbim të lehtësimit të sanksioneve të rënda perëndimore të vendosura pas një shtypjeje vdekjeprurëse të disidencës nga udhëheqësi autoritar, Aleksandr Lukashenko, pasi ai pretendoi fitoren në zgjedhjet e vitit 2020, të cilat opozita dhe shumë vende perëndimore i cilësuan si "të manipuluara".

Coale foli më 17 shtator me Artyom Radygin nga Shërbimi i programeve në rusisht të Radios Evropa e Lirë, për përmirësimin e marrëdhënieve mes Uashingtonit dhe Minskut që nga kthimi i presidentit amerikan, Donald Trump, në Shtëpinë e Bardhë në janar të vitit 2025 dhe për drejtimin e marrëdhënieve diplomatike.

Radio Evropa e Lirë: Në mars, u liruan 250 njerëz, të burgosur politikë, por javën e kaluar ishin vetëm 25. Është një lajm i shkëlqyeshëm që 25 njerëz u liruan nga burgu, por megjithatë është shumë interesante se çfarë ndodhi. Pse u ul numri?

John Coale: Në përgjithësi, janë liruar 800 deri në 900 të burgosur dhe nganjëherë janë liruar 150, e nganjëherë 14. Pra, sado që mund të arrij t'i nxjerr në këtë çast, i nxjerr. Besoj se në negociatat e mia të fundit, të cilat janë ende në vazhdim, në një të ardhme shumë të afërt mund t'i nxjerrim edhe 100, mbi 100 njerëz, dhe do ta bëjmë këtë... ndoshta brenda një muaji apo kështu diçka.

Radio Evropa e Lirë: Cilat çështje duhet të zgjidhen para se kjo të bëhet realitet?

John Coale: Epo, gjëra të tilla si fakti që në të kaluarën kemi hequr disa sanksione për të nxjerrë njerëzit nga burgu dhe duhet të sigurohemi që bankat dhe bizneset në Shtetet e Bashkuara ta kuptojnë se çfarë nënkupton heqja e sanksioneve, pra që në thelb është në rregull të bësh biznes në këtë zonë.

Kështu që duhet të kthehemi dhe ta rregullojmë një pjesë të kësaj. Ne nuk e dinim se bizneset dhe bankat amerikane, si dhe institucione të tjera, nuk e kuptonin se çfarë nënkuptonte kjo. Pra, duhet ta bëjmë këtë dhe më pas do të rikthehemi.

Radio Evropa e Lirë: [Djemetëqesja e opozitës bjelloruse në mërgim] Svyatlana Tsikhanouskaya pretendon se Aleksandr Lukashenko i shet te burgosurit në këmbim të heqjes së sanksioneve. Pra, a krijojnë këto marrëveshje, heqja e sanksioneve, një nxitje për Lukashenkon që të arrestojë më shumë të burgosur politikë, në mënyrë që të ketë diçka për të shkëmbyer?

John Coale: Nuk jam i sigurt... Çdokush me të cilin flas jep një numër të ndryshëm të njerëzve që arrestohen tani.

Pra, nuk e di cili është numri real. Por nëse Lukashenko po shkëmben të burgosur për lehtësim të sanksioneve, për mua është në rregull, sepse jam unë ai që u shikon në sy të burgosurve të liruar dhe shoh se çfarë do të thotë liria për ta. Për mua, kjo është shumë më e rëndësishme sesa disa çështje politike që mund t'i ketë dikush jashtë.

Çështja ime dhe çështja e Shteteve të Bashkuara është humanitare, për t'i ndihmuar njerëzit. Nëse mund t'i nxjerr 25 njerëz, mendoj se është shumë mirë. Nëse mund t'i nxjerr 200, është shumë më mirë. Pra, kështu e shohim ne. Dhe, e dini, Svyatlana mund të ketë mendimin e saj, unë mund të kem timin.

Mendoj se një ditë Shtetet e Bashkuara do të donin të kishin më shumë lidhje ekonomike me Bjellorusinë. Mendoj se Perëndimi do të donte që kjo të ishte gjendja normale.

Radio Evropa e Lirë: Aleksandr Lukashenko e sheh këtë ndryshe. Ai mohon se këta persona të liruar janë të burgosur politikë. Si ju përgjigjet atij?

John Coale: Unë i quaj të burgosur. Nëse ai dëshiron që unë t'i quaj kështu, do t'i quaj lepuj nëse kjo do të bëjë që t'i nxjerr jashtë, nuk më intereson. Pra, nëse ai beson se nuk janë të burgosur politikë, le ta besojë këtë. Unë thjesht njoh njerëz. Kështu që, për mua, semantika e kësaj çështjeje nuk është vërtet e rëndësishme. Mund të jetë e rëndësishme për njerëzit e tjerë, por për mua nuk është.

Radio Evropa e Lirë: A ka synime të tjera të vizitave tuaja në Bjellorusi, përveç lirimit të të burgosurve politikë?

John Coale: Po. Kanë qenë të burgosurit, por gjithashtu edhe që Qeveria bjelloruse të sillte më mirë nga sa mendoj se është sjellë me disa prej fqinjëve të saj, në mënyrë që të mund ta rikthejmë në familjen e kombeve. Edhe ata pajtohen me këtë. Kemi ecur hap pas hapi gjatë një viti e gjysmë të fundit dhe mendoj se po bëjmë përparim, por, sigurisht, Lukashenko e ka vendin e vet që duhet ta udhëheqë, e ka një aleat, [presidentin rus Vladimir] Putin, jashtë vendit, kështu që është e ndërlikuar.

Por mendoj se bota do të ishte vend më i mirë nëse Bjellorusia do të ishte në komunikim me pjesën tjetër të botës në mënyrë të mirë. Dhe mendoj se ata po përpiqen.

Radio Evropa e Lirë: Çfarë ju bën të sigurt se Bjellorusia mund të riintegrohet me sukses në familjen e kombeve?

John Coale: Ata po përpiqen dhe po shkojmë në atë drejtim. Nuk jam aq i sigurt, por ne po bëjmë përparim, ata po bëjnë përparim. Pra, mendoj se po shkojmë në drejtimin e duhur. Nuk mendoj se kjo ndodh brenda natës. Është një proces i vërtetë. Dhe aleatja e saj më e madhe është Rusia, ndërsa Bjellorusia është një nga aleatët e paktë që ka Rusia. Kështu që ata duhet ta zgjidhin këtë, jo unë.

Radio Evropa e Lirë: Pra, a është e mundur të institucionalizohen marrëdhëniet e ardhshme mes Shteteve të Bashkuara dhe Bjellorusisë, apo ato do të bazohen në një ekuilibër të thjeshtë të fuqisë?

John Coale: Jo, mendoj se mund t'i institucionalizojmë. Mendoj se duhet ta rihapim ambasadën tonë. [Shënim i redaktorit: Shtetet e Bashkuara pezulluan veprimtarinë në ambasadën e tyre në Minsk në shkurt 2022, menjëherë pasi Rusia e nisi pushtimin e Ukrainës, me disa sulme të nisura nga territori bjellorus].

Ka shumë hapa që duhen të ndërmerren. Por ajo që kam mësuar është se kjo është gjë graduale. Është një botë shumë komplekse. Kjo është gjë graduale. Por për mua, po shkon në drejtimin e duhur, gjë që është shumë më mirë sesa drejtimi i gabuar.

Radio Evropa e Lirë: Ju përmendët më herët se dëshironi ta zgjidhni çështjen e Bjellorusisë përpara se të fokusoheni te Rusia. Pra, si planifikoni t'i qaseni Kremlinin?

John Coale: Epo, mund t'i bëj të dyja. Mund të vazhdoj atë që po bëj me Bjellorusinë. Dhe kam folur me njerëz, dhe [i dërguari i posaçëm i SHBA-së] Steve Witkoff do të duhej të përfshihej, si dhe [i dërguari i posaçëm amerikan për paqen] Jared [Kushner], për të bërë një lloj shkëmbimi të të burgosurve civilë. Kam folur me ta dhe po bëjmë përparim.

Radio Evropa e Lirë: A keni bërë ndonjë përparim sa u përket shtetasve amerikanë që ndodhen aktualisht në Rusi?

John Coale: Epo, shtetasit amerikanë, por gjithashtu do të doja të ktheja disa prej rusëve dhe ukrainasve në vendet e tyre.

Radio Evropa e Lirë: Aleksandr Lukashenko ka përmendur në intervistat e tij se po i ofrohet Donald Trumpit dhe liderëve të tjerë si ndërmjetësues me Kremlinin. A e sheh Donald Trump Lukashenkon si një ndërmjetësues të mundshëm?

John Coale: Mendoj se mbase, po, sepse ekziston një marrëdhënie më shumë se 30-vjeçare mes Putinit dhe Lukashenkos. Ata janë miq. Njëri është vëllai i madh, tjetri është vëllai i vogël, por janë miq dhe flasin. Flasin gjatë gjithë kohës. Dhe Lukashenko e viziton shpesh Moskën. Pra, kjo do të ishte e dobishme. Ai mund të ishte i dobishëm si ndërmjetësues mes luftërave, me luftën.

Radio Evropa e Lirë: Por aktualisht, kur shikojmë lajmet për shkëmbimin e të burgosurve, gjithmonë ka diçka për sanksionet që po hiqen. Kush zgjedh se cilat sanksione do të vendosen në tryezë përpara se të lirohen të burgosurit?

John Coale: Epo, në Bjellorusi, këtë e bëj unë, dhe pastaj flas me sekretarin e shtetit ose vetë presidentin, dhe kalojmë përmes një procesi. Pra, John Coale mendon se duhet t'i heqim sanksionet ndaj kësaj, kësaj dhe kësaj. Dhe ose miratohet, ose thuhet: "Epo, këtë nuk mund ta bësh, por këtë mund ta bësh".

Radio Evropa e Lirë: Si e matni suksesin?

John Coale: Duke i nxjerrë njerëzit nga burgjet. Duke i nxjerrë dhe duke i parë të ribashkohen me familjet e tyre. Ne dalim bashkë me ta dhe ndonjëherë familjet janë njoftuar, ose ambasadorë të vendeve të ndryshme dalin për t'i përshëndetur, u japim telefona që të telefonojnë familjet e tyre; familja nuk ka fare dijeni se ata janë të lirë, dhe është një moment gëzimi. Kështu e mat suksesin.

Radio Evropa e Lirë: Do të doja të kthehesha te shkëmbimi i të burgosurve civilë mes Rusisë dhe Ukrainës. Cili është statusi aktual dhe cilat janë perspektivat e këtij procesi?

John Coale: Mendoj se po fillon, mendoj se ideja është në tryezë, si të thuash, dhe kur të kthehem në Uashington do të shtyj më tej për këtë, sepse mendoj se është një gjë e rëndësishme.

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *


POSTOJE KOMENTIN

Zgjedhjet në Gjermani vënë në provë Merz, tronditet ekuilibri politik

14:10 Bota

Fico: Nuk dua që Slovakia të përfshihet në luftë për shkak të Nenit 5 të NATO-s

13:40 Bota



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.